



Funded by
the European Union

Raporti 2022

"Trajtimi i rasteve të të drejtave të punëtorëve nga Inspektorati i Punës dhe Gjyqësori"



Autor: Kastriot Berisha
Hulumtues: Behar Mustafa
Redaktor: Kreshnik Gashi
Lektura: Përparim Isufi

Defektet në Implementimin e Standardeve nga Inspektorati i Punës

Standardi	Implementimi
Barazia gjinore dhe mos diskriminimi brenda Inspektoratit të Punës	×
Përdorimi i të dhënave dhe databazave për dokumentimin e shkeljeve	×
Rritja e raportimit nga punonjësit në sektorin privat	×
Trajtimi profesional dhe me standarde i ankesave	×
Vendosja e rasteve konform udhëzimeve të gjykatave	×
Ulja e numrit të aksidenteve në punë	×
Imponimi i zbatimit të Ligjit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë	×

Defektet në implementimin e standardeve nga sistemi i drejtësisë

Standardi	Implementimi
Ndërtimi i parimeve në trajtimin e kompetencave	×
Zbatimi i zotimit strategjik për prioritizim të rasteve	×
Hetimi i rasteve të lëndimeve në punë	×
Trajtimi me kohë i kallëzimeve penale	×
Gjykimimi me kohë i aktakuzave	×
Zbatimi i standardit kohor për gjykim	×
Zbatimi i politikës ndëshkimore	×

Përmbajtja

Hyrje	5
Përmbledhja Ekzekutive	7
Metodologjia	10
1. Sfidat e inspektimit	10
1.1 Resurset humane në inspektoratin e punës	11
1.2 Mungesa e databazës	12
1.3 Neglizhimi i obligimit për raportimin e rasteve në prokurori	12
1.4 Dominimi i ankesave nga shërbyesit publikë	13
1.5 Standardet e shturura në trajtimin e ankesave në shkallën e parë	14
1.6 Konstatimet e parregullsive dhe vonesave në shkallën e dyt	16
1.7 Paqartësia ligjore në vendimmarrjen në mes inspektoratit dhe gjykatave	17
1.8 Dështimi për të ulur numrin e aksidenteve në punë	18
1.9 Rezultatet e dobëta në imponimin e zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë	20
1.9.1 Mungesa e specialistëve dhe ekspertëve për siguri në punë	22
1.9.2 Mungesa e kontrolleve mjekësore	22
2. Trajtimi gjyqësor i çështjeve të punës	23
2.1 Dështimi i gjykatave për zbatimin e standardit për gjykim në kohë të arsyeshme	23
2.2 Neglizhenca në trajtimin e rasteve penale	25
2.2.1 Trajtimi i rasteve nga gjykata dhe prokuroria në pejë	27
2.2.2 Trajtimi i rasteve nga gjykata dhe prokuroria në Gjakovë	27
2.2.3 Trajtimi i rasteve nga gjykata dhe prokuroria në Prishtinë	28
2.2.4 Trajtimi i rasteve nga gjykata dhe prokuroria në Mitrovicë	28
2.2.5 Trajtimi i rasteve nga gjykata dhe prokuroria në Ferizaj	29
2.2.6 Trajtimi i rasteve nga gjykata dhe prokuroria në Prizren	29
2.2.7 Trajtimi i rasteve nga gjykata dhe prokuroria në Gjilan	30
3. Rekomandimet	31

Hyrja

Si shteti më i ri në rajon, Kosova është zotuar në zbatimin e standardeve dhe vlerave evropiane në liritë dhe të drejtat e njeriut përfshirë këtu zbatimin e të drejtave të punëtorëve.

E drejta e punës dhe zgjedhjes së lirë së profesionit është liri dhe e drejtë themelore e garantuar me Kushtetutë ndërsa me ligj të veçantë garantohet ndërmarrja e masave parandaluese që kanë synim përmirësimin e kushteve të punës, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, përmirësimin e ambientit të punës, mbrojtjen fizike dhe psikike të punësuarave dhe të tjerëve që marrin pjesë në procesin e punës.

Përkundër këtyre zotimeve të përfshira në Kushtetutë dhe në ligjet përkatëse, statistikave tregojnë se siguria në vendin e punës vazhdon të jetë sfidë.

Nga viti 2011 e deri në gjysmën e vitit 2022 nga aksidentet në punë kanë vdekur 141 punëtorë. Të dhënat tregojnë që veprimet e institucioneve nuk kanë arritur të ndikojnë në uljen e vdekjeve pasi numri i vdekjeve është rritur vit pas vitit.

Niveli i implementimit të ligjit tregohet më së miri me nivelin e përmbushjes së obligimit për të kryer vlerësimin e rrezikut në punë. Vetëm 1.55% e bizneseve të regjistruara në vend e kanë përmbushur këtë element bazik të sigurisë në punë.

Vendi vazhdon të përballlet me nivel të lartë të ekonomisë joformale dhe nivel të lartë të papunësisë.

Të dhënat tregojnë që një e treta ekonomisë në Kosovë është joformale, ndërsa edhe shkalla e informalitetit në punësim është në shkallë të njëjtë¹. Sektorët me shkallën më të lartë të informalitetit janë ai i ndërtimitarisë dhe bujqësia. Edhe pse në vend nuk ka statistika dhe matje për numrin e punëtorëve të përgjithshëm, të dhënat e Inspektoratit të Punës tregojnë që gjatë vitit 2021 në 10,162 inspektime u hasën 1,459 punëtorë pa kontrata pune dhe 433 punëtorë të padeklaruar në ATK.

Baza ligjore e cila rregullon të drejtat e punëtorëve vazhdon të mbetet sfiduese. Ligji i punës, i miratuar në dhjetor të vitit 2010, nuk ka arritur të plotësohet e ndryshohet përkundër faktit që prej kohësh janë identifikuar zbrazëtira gjatë fazës së implementimit.

Institucionet e drejtësisë po ashtu kanë krijuar sfida me interpretimet e këtij ligji pasi vendimet e Gjykatës Supreme dhe gjykatave të rregullta në shumë raste kanë konstatuar se vendimet e Inspektoratit kanë cenuar pavarësinë e gjyqësorit pasi kanë vendosur paralelisht me gjykatat.

Implementimi i ligjit ka sfida të mëdha në terren. Inspektorati i Punës ka kapacitete të limituara të inspektimit, ndërsa çështjet gjyqësore të incidenteve dhe lëndimeve në punë të cilat trajtohen nga gjykatat kërkojnë vite për t'u zgjidhur.

Edhe pse ligji e parasheh që gjykatat duhet me prioritet të trajtojnë kontestet e punës, të dhënat tregojnë që në praktikë duhen mbi dy vjet që një rast i tillë të zgjidhet në shkallën e parë. Procedura mund të zgjatet edhe më shumë në rastet kur ka ankesa në Gjykatën e Apelit.

Situata është e ngjashme me vendimet në rastet penale ku trajtimi zgjat me vjet ndërsa dënimet ndaj bizneseve janë të ulëta.

Performanca e institucioneve është jo e mirë edhe në inspektime. Inspektorati i Punës vazhdon të përballlet me numër të vogël të raportimeve ndërsa cilësia e trajtimit të raportimeve lë për të dëshiruar pasi vendimet e kontestuara kthehen në rishqyrim në 93% të rasteve

Matjet e shoqërisë civile tregojnë që qindra punëtorë punojnë në kushte të vështira por janë të detyruar të heshtin pasi në të kundërtën humbja e vendit të punës është e sigurt.²

Në sektorin privat, aty ku shkeljet janë më të mëdha, Kosova nuk ka arritur të krijojë mekanizma sindikalë të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve.

¹ Infomaliteti ekonomik në Kosovës sipas Odës Ekonomike dhe Administratës Tatimore të Kosovës, <https://www.monitor.al/informaliteti-ne-kosove-shume-i-larte-vetem-36-mije-biznese-te-fiskalizuara/>
² Të heshtësh ose të durosh, raporti i IKS, publikuar në prill 2022, <https://iksWeb.org/ep-content/uploads/2022/04/Te-Heshtesh-ose-te-Largohesh-nga-puna-b-3.pdf>

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit vlerëson se Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efektive ligjet e punës, të cilët përfshinin rregullore dhe udhëzime administrative që i rregullojnë marrëdhëniet e punësimit, përfshirë të drejtën e lirisë së asociimit dhe negociimit kolektiv.³ Ky raport vlerëson se masat mbrojtëse të Qeverisë nuk mjaftonin për të siguruar zbatim të ligjit, për t'i identifikuar dhe mbrojtur viktimat, dhe për t'i hetuar pohimet për punë të dhunshme apo të detyruar. Raporti i DASH-it, kritikon edhe tejkalimin e orarit të punës dhe moszbatimin në mënyrë efektive të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë e po ashtu edhe dënimet për shkeljet të cilat sipas tyre nuk ishin në përputhje me ato të ligjeve të ngjashme.⁴

Situatë jo e mirë në të drejtat e punëtorëve u konstatua edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2021. Ky raport konstatoi se numri i punëtorëve të pa formalizuar vazhdon të jetë i lartë në Kosovë, përkundër faktit se regjistrimi i tyre kishte trend rritje pas masave financiare të cilat i kishte siguruar Qeveria.

Raporti i Komisionit Evropian ndër të tjera konstaton se ka pasur përparime përafrimin e legjislacionit të punës me direktivat e BE-së, por prapëseparapë zbatimi i tyre ka qenë i dobët, veçanërisht në sektorin privat. Raporti i Progresit konstaton se Inspektorati i Punës ka kryer një numër të shtuar inspektimesh por me shumë pak ndikim në terren, dhe se e konsideron shqetësues faktin se numri i aksidenteve në punë po vazhdon të rritet.⁵

Edhe raportet e shoqërisë civile në Kosovë për zbatimin e Ligjit të Punës tregojnë për ngecje në zbatim të ligjeve dhe shkelje të shpeshta të të drejtave të punëtorëve.⁶

Ankesat e punëtorëve të sektorit privat vazhdojnë të jenë të ulëta edhe pse ky sektor është më i prekuri nga parregullsitë dhe shkeljet e Ligjit të Punës.

³ Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën, publikuar në vitin 2022, https://xk.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/133/HRRreportKosovo2021_Alb.pdf

⁴ Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën, publikuar në vitin 2022, https://xk.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/133/HRRreportKosovo2021_Alb.pdf

⁵ Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, publikuar në vitin 2021, <file:///C:/Users/Admin/Downloads/Kosovo%202021%20report.PDF>

⁶ Raporti i IKS për zbatimin e Ligjit të Punës në Kosovë, publikuar në vitin 2020 <https://iksweb.org/wp-content/uploads/2020/10/report-labour-law-implementation-FINAL-Shqip.pdf>

Përmbledhja ekzekutive

Procesi i trajtimit të ankesave të punëtorëve për shkeljen e të drejtave të punës, sigurinë në punë dhe çështjet që lidhen me punësimin ka sfida të mëdha të cilat pengojnë krijimin e një ambienti të favorshëm për të mbrojtur punëtorët. Të dhënat e grumbulluara nga ky raport tregojnë se:

- Institucionet e Kosovës nuk kanë arritur të ndërtojnë një sistem komunikimi i cili do të mundësonte identifikimin e shkeljeve të ligjit të punës dhe lëndimeve në punë;
- Punëtorët institucionalë përfshirë mjekët nuk kanë një mekanizëm që do të raportonte lëndimet e punëtorëve si rezultat i aksidenteve në vendin e punës. ATK dhe Inspektorati i Punës nuk komunikojnë për të adresuar shkeljet të cilat adresohen nga këto institucione;
- Inspektorati i Punës nuk raporton në prokurori shkeljet penale ndërsa gjykata nuk mund të ketë qasje në databaza të Inspektoratit për të kontrolluar të dhëna;
- Limite të tjera konstatohen në paqartësitë ligjore dhe mungesën e infrastrukturës teknike për raportimin dhe dokumentimin e shkeljeve të të drejtave të punëtorëve; dhe
- Sistemi i drejtësisë vazhdon të jetë sabotues dhe neglizhues në trajtimin penal e civil të rasteve të të drejtave të punëtorëve.

Hulumtimi i BIRN ka gjetur probleme serioze në funksionimin e mekanizmave të ankesës, padive dhe trajtimit të tyre nga Inspektorati i Punës dhe sistemi i drejtësisë.

Problemet mund të grupohen në mungesën e bazës ligjore, mungesën e kapaciteteve profesionale dhe mungesat teknike në terren.

Në bazën ligjore, Inspektorati i Punës dhe i gjithë sistemi sfidohen nga paqartësia pas vendimit të Gjykatës Supreme e cila ka vendosur që t'i kërkojë Gjykatës Kushtetuese interpretimin e mandatit të Inspektoratit të Punës në disiplinim, shqiptim gjobash dhe kthim në punë të punëtorëve.

Si rrjedhojë e kësaj paqartësie juridike për disa vite gjykatat kanë anuluar dhjetëra vendime të Inspektoratit të Punës të kësaj natyre.

Pas gati 2 vitesh, Gjykata Kushtetuese e ka trajtuar kërkesën e Gjykatës Supreme dhe ka konstatuar se Inspektorati i Punës kundërligjshëm i kishte tejkaluar kompetencat dhe kishte marrë rolin e gjykatës kur kishte vendosur për lëndë të ndryshme. Kushtetuesja konstatoi se asnjë inspektorat nuk mund të ushtrojë funksione të natyrës gjyqësore, dhe se për kthimin në punë, kërkesat për pagat dhe ligjshmërinë e vendimeve vendos vetëm gjykata.

Baza ligjore në Inspektorat sfidohet edhe me çështje të tjera të cilat lidhen me mungesën e rishikimit të Ligjit të Punës. Problemet rreth mandatit do të mund të qartësoheshin me rishikim të ligjit.

Brenda institucionit mungojnë udhëzime të qarta për shqiptimin e gjobave. Diskrecioni i inspektorëve në shqiptimin e gjobave për shkeljen e dispozitave nuk është i rregulluar fare dhe hapësira e madhe në mes të minimumit dhe maksimumit të lartësisë së gjobës nuk e përjashton mundësinë e keqpërdorimeve nga ana e inspektorëve të punës. Si rrjedhojë është konstatuar se disa biznese nuk janë ndëshkuar ose kanë marrë gjoba të ulëta për shkelje të cilat parashihen dënime të larta.

Kapacitetet profesionale brenda Inspektoratit të Punës janë të limituara dhe nuk i përgjigjen nevojës në terren. Një Inspektor është përgjegjës që mesatarisht të mbikëqyr 3 mijë biznese ndërsa më pak se 10 % e bizneseve vizitohen nga inspektorët brenda vitit.

Përpos mungesës së stafit edhe performanca profesionale e stafit lë për të dëshiruar. 93.3% e vendimeve të shkallës së parë të nxjerra nga inspektorët janë anuluar ose janë kthyer në rishqyrtim nga komisioni i ankesave.

Analizimi i këtyre vendimeve tregon për mungesë profesionalizmi pasi në asnjë nga vendimet e shkallës së parë nuk është arsyetuar lartësia e gjobës.

Të dhënat tregojnë që përkundër rreth 10 mijë inspektimeve, impakti i tyre në terren është i ulët pasi udhëzimet nuk respektohen nga bizneset.


Kriteri bazik për sigurinë në punë është vlerësimi i rrezikut në punë. Edhe pse 112 mijë biznese janë aktive në Kosovë, vetëm 1,740 prej tyre e kanë përmbushur këtë obligim

Performanca e inspektorëve është e ulët edhe në implementimin e obligimit që inspektorët të bëjnë kallëzime penale në prokurori për bizneset që hasen në shkelje penale. Inspektorati nuk ka dorëzuar asnjë kallëzim penal në prokurori për bizneset e inspektuara.

Në çështje teknike dhe menaxheriale, Inspektorati nuk ka të ndërtuar platformë për raportim të rasteve apo platformë të kontrollimit të të dhënave të punëtorëve nga distanca.

Brenda Inspektoratit të Punës nuk ka një bazë të regjistrimit të të dhënave përfshirë këtu listën e gjobave dhe bizneseve të dënuara dhe kjo bën që inspektorët të mos kenë mundësi të dinë se cili nga bizneset është shkelës recidivist. Kjo bën që niveli i gjobave nuk ndryshon as për bizneset që janë shkelës recidivistë.

Sistemi i drejtësisë po ashtu është hallkë problematike në trajtimin e çështjeve të punës dhe sigurisë në punë. 64% e rasteve të kontesteve të punës në gjykata mbesin pa u trajtuar brenda vitit. Statistikisht, gjykata konstaton në 72 % të rasteve që punëtorët kanë pasur të drejtë në paditë e tyre.



Në 88% të rasteve të cilat janë analizuar për qëllim të këtij raporti janë konstatuar vonesa nga gjykatat ndërsa në 37% të rasteve vonesat janë konstatuar në Prokurorinë e Shtetit.

Sistemi i drejtësisë ka shqiptuar dënime të buta ndaj shkelësve të ligjit në çështjet e sigurisë në vendin e punës. Në 11 raste janë shqiptuar dënime me gjobë, në 5 raste dënime me kusht ndërsa në 4 raste dënime me burgim efektiv.

Të dhënat tregojnë se nga 20 aktgjykimet dënuese të analizuar, gjykatat kanë marrë për bazë plot 111 rrethana lehtësuese ndërsa vetëm 21 rrethana rënduese.

Në 14 nga 20 aktgjykimet dënuese të analizuar nuk është zbatuar Udhëzuesi i Politikës.

Nga 20 aktgjykimet dënuese, në vetëm katër raste është shqiptuar dënimi me burgim efektiv.

Këto të dhëna tregojnë se sistemi i drejtësisë ka një qasje jashtëzakonisht të butë ndaj bizneseve që kanë shkelur rregullat e sigurisë në punë dhe janë përgjegjëse për fatkeqësitë në punë.

Metodologjia

Ky raport përmban të dhëna të grumbulluara nga intervista direkte, analizim i raporteve statistikore dhe analizim i thellë i dosjeve të rasteve të trajtuara.

Për qëllime të këtij raporti janë analizuar 30 vendime në shkallë të parë dhe shkallë të dytë të Inspektoratit të Punës. Përzgjedhja e vendimeve është bërë në bazë të kohës së trajtimit duke përfshirë rastet e para të trajtuara nga secili rajon i Inspektoratit të Punës për vitet 2020 dhe 2021 si dhe vendimet e para të Komisionit të Ankesave të këtij institucioni për vitet 2019, 2020 dhe 2021.

Të dhënat për pjesën e sigurisë në punë janë mbledhur në intervista direkte dhe analizim i të dhënave statistikore.

Pjesa e tretë e raportit e cila e trajton performancën e sistemit të drejtësisë është hartuar duke analizuar dosjet e 27 rasteve gjyqësore të trajtuara nga gjykatat e Kosovës. Dosjet që janë analizuar janë përzgjedhur në bazë të kohës së trajtimit dhe atë katër rastet e para të trajtuar nga secila gjykatë për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

1. Sfidat e inspektimit

Inspektorati i Punës është organ i pavarur ekzekutiv i cili ka për detyrë mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore të cilat rregullojnë marrëdhëniet juridike kontraktuale, të drejtat dhe detyrimet e palëve në raportet e krijuara juridike në procesin e punës. Ky inspektorat është i autorizuar që të kryejë inspektime në sektorin publik dhe në sektorin privat.⁷

Përpos Ligjit të Punës dhe Sigurisë në Punë, Inspektorati i Punës mbikëqyr edhe zbatimin e një numri të madh të ligjeve të tjera si Ligji për Kontrollin e Duhanit, Ligji për Grevat, Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Ligji për të Huajt, Ligji për Organizimin Sindikal, Ligji për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri dhe Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Hulumtimi i BIRN ka gjetur probleme dhe sfida në:

- Resurset humane dhe diskriminimi gjinor në Inspektoratin e Punës;
- Mungesën e databazave dhe të dhënave;
- Neglizhimi i obligimit për raportimin e rasteve në prokurori;
- Dominimi i ankesave nga shërbyesit publikë;
- Standardet e shturura në trajtimin e ankesave;
- Konstatimet e parregullsive dhe vonesave në shkallën e dytë;
- Paqartësia ligjore në vendimmarrjen mes Inspektoratit dhe gjykatave;
- Paaftësia për të ulur numrin e aksidenteve në punë; dhe
- Paaftësia për të imponuar zbatimin e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

⁷ Ligji për Inspektoratin e Punës, <https://gjk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3252>

1.1 Resurset humane në Inspektoratin e Punës

Me misionin që të garantojë barazi dhe trajtim të barabartë në punësim, Inspektorati i Punës është institucion që në resurset e veta humane shkel ligjin për barazinë gjinore. Vetëm 6 gra punojnë në këtë institucion i cili dominohet nga burrat.⁸ Nga 13 pozitat menaxhuese në këtë institucion, vetëm tre prej tyre udhëhiqen nga gratë.

Inspektorati i Punës ka sfida të mëdha edhe në rekrutimin e stafit dhe arritjen e qëllimeve për çka është themeluar.

Kosova ka të regjistruara mbi 112 mijë biznese aktive, mbikëqyrja e të cilave në aspektin e të drejtave të punës dhe sigurisë në punë u është besuar rreth 40 inspektorëve të punës në vitet e fundit.


Numri i inspektorëve të punës sipas viteve në Kosovë

Viti 2020		Viti 2021		Viti 2021	
Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
39		37		37	
33	6	33	6	33	6

Siç shihet në tabelë, në vitin 2020 për të gjithë territorin e Kosovës kanë qenë të angazhuar 39 inspektorë të punës, në vitin 2021 numri ka rënë në 37, ndërsa në vitin 2022 numri i inspektorëve të punës të është 38 inspektorë.

Në Kosovë, sipas të dhënave zyrtare, llogaritet të jenë 112 mijë biznese aktive dhe nëse përpjesëtohet numri i bizneseve me numër të inspektorëve i bie që një inspektor të jetë përgjegjës për inspektimin e rreth 3 mijë bizneseve brenda një viti. Marrë parasysh që janë 260 ditë punë brenda një viti, i bie që një inspektor duhet të vizitojë 12 biznese brenda një dite. Nëse i viziton 3 biznese në ditë, atëherë i bie që një biznes të ketë vizitë nga inspektorët një herë në 4 vjet.⁹

Bizneset sipas rajoneve



⁸ Të dhënat e nxjerra nga raporti vjetor i Inspektoratit të Punës, <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf>

⁹ Të dhënat e nxjerra nga përgjigjet e Administratës Tatimore të Kosovës

Ndërkaq nëse ky numër pjesëtohet sipas rajoneve, del se në Prishtinë një inspektor gjatë këtyre tre viteve të fundit ka qenë përgjegjës për inspektimin e 4,490 bizneseve, pasi në Prishtinën me rreth 50 mijë biznese janë të angazhuar vetëm 11 inspektorë të punës.⁹

1.2 Mungesa e databazës

Inspektorati i Punës është institucion i cili funksionon pa një databazë elektronike. Si rrjedhojë, akoma pranimi dhe regjistrimi i ankesave dhe vendimeve bëhet në mënyrë manuale.¹⁰

Mungesa e databazës e vështirëson punën e Inspektoratit si në aspektin e hartimit të raporteve vjetore si dhe në aspektin e trajtimit të inspektimeve.

Në mungesë të databazës, inspektorët e kanë të vështirë të verifikojnë nëse një biznes është përsëritës i shkeljeve ligjore, rrethanë kjo e cila ndikon në ashpërsimin e gjobave ndëshkimore. Në 14 rastet e analizuara mungon informacioni nëse para vendimmarrjes inspektori ka kontrolluar nëse biznesi është recidivist.

Përsëritja e shkeljeve konsiderohet rrethanë e cila ndikon që gjobat dhe ndëshkimet të jenë më të rënda për personat që e përsërisin shkeljen e njëjtë.

Shqiptimi i një dënimi më të rëndë për përsëritjen e shkeljeve parashihet me Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e gjobave për shkeljet e Ligjit të Punës, mirëpo ky Udhëzim është vështirë të zbatohet në mungesë të një databaze.¹¹

1.3 Neglizimi i obligimit për raportimin e rasteve në prokurori

Kodi Penal i Republikës së Kosovës i kushton një rëndësi të veçantë të drejtave të punëtorëve. Një kapitull i këtij Kodi i është kushtuar veprave penale kundër marrëdhënies së punës.¹² Këto vepra penale më së lehti mund të identifikohen pas inspektimeve të inspektorëve të punës.

Vepra të cilat lehtësisht mund të konstatohen gjatë kontrolleve nga Inspektorati janë "Cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës", "Cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë" dhe "Keqpërdorimi i të drejtës në grevë".

Një numër i madh i kontrolleve të Inspektoratit konstatojnë cenim të të drejtave nga marrëdhënia e punës mirëpo asnjëherë nuk ka ndodhur që të dorëzohet ndonjë kallëzim penal për cenimin e tyre. Përpos kontrolleve për cenim të marrëdhënies së punës, Inspektorati për vite me radhë ka inspektuar konkurse të ndryshme pune ku ka konstatuar parregullsi të shumta mirëpo as në këto raste nuk ka dorëzuar ndonjë kallëzim penal.

Edhe pse brenda një viti Inspektorati realizon mesatarisht 10 mijë inspektime, në asnjë rast nuk ka raportuar në organet ndjekëse ndonjë dyshim për kryerje të veprave penale.

Është obligim ligjor i çdo institucioni publik dhe çdo zyrtari që në rastet kur hasin në dyshimet për vepra penale të informojnë prokurorin e shtetit përmes parashtrimit të kallëzimit penal.

¹⁰Përgjigja e datës 2 nëntor 2022 nga Inspektorati i Punës.

¹¹Neni 9 i UA për përcaktimin e Gjobave dhe shumave konkrete për shkeljen e dispozitave të Ligjit të Punës e parashih përsëritjen e shkeljes si arsye për shqiptimin e dënimit maksimal, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8160>

¹²Kapitulli XIX i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

Madje moslajmërimi i veprës penale përbën vepër penale, dhe personi i cili nuk e raporton një vepër të tillë parashihet të ndiqet penalisht.¹³

Mungesa e kallëzimeve penale i ka amnistuar nga përgjegjësia biznesmenët e menaxherët për shkelje të të drejtave të punëtorëve.


1.4 Dominimi i ankesave nga shërbyesit publikë

Numri i ankesave të punëtorëve në Inspektoratin e Punës është duke u rritur nga viti në vit. Sipas raportit të punës së këtij institucioni gjatë vitit 2020 dhe 2021 mbi bazën e ankesave janë kryer 15,584 inspektime.

Numri i inspektimeve të kryera nga raportimet e punëtorëve duket të jetë i lartë, mirëpo kur analizohet numri i ankesave sipas paraqitësit atëherë rezulton se ankesat nga punëtorët e sektorit privat vazhdojnë të jenë të pakta ndërsa numri më i madh i ankesave paraqiten nga punonjësit e shërbimeve publike.

Brenda një muaji gjatë vitit 2020 dhe 2021 nga punëtorët e sektorit privat paraqiten mesatarisht 60 ankesa në muaj në të gjithë Kosovën. Nëse ky numër ndahet në shtatë rajonet ku ka zyrë Inspektorati i Punës atëherë del se në një rajon paraqiten vetëm 8.5 ankesa në muaj nga punëtorët e sektorit privat të cilët njëherit përbëjnë shumicën e punëtorëve në Kosovë.

Për dallim nga sektori privat, numri i ankesave nga punëtorët e sektorit publik është shumëfish më i lartë. Gjatë vitit 2020 dhe 2021 nga punëtorët e këtij sektori kanë paraqitur plot 14,154 ankesa, apo 589 ankesa në muaj.




¹³ Neni 378 paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës përcakton se : "Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili nuk e lajmëron veprën penale të cilën e ka zbuluar gjatë ushtrimit të detyrës së tij, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni, nëse vepra e tillë është e dënueshme me së paku tre (3) vjet burgim"
<https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6A2D4377-6AE1-4530-909F-3FB2680CD1EC.pdf>

Numri i të punësuarve në të gjithë Kosovën sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës del të jetë rreth 354 mijë.¹⁴ Prej tyre 286 mijë dalin të jenë të punësuar në sektorin privat.¹⁵

Një nga arsyet të cilat mund të konkludohet se ka ndikuar që numri i ankesave nga punëtorët e sektorit privat të jetë kaq i ulët është mungesa e një mekanizmi raportimi në Inspektoratin e Punës.

Aktualisht ankesat paraqiten në mënyrë fizike në njërin nga rajonet e Inspektoratit të Punës.



Shumica e institucioneve në Kosovë tashmë kanë krijuar mekanizmat dhe manualët për raportimin e shkeljeve të ndryshëm, përdërisa një gjë e tillë akoma nuk është mundur nga Inspektorati i Punës dhe rrjedhimisht qytetarët vazhdojnë të mbeten të painformuar për të drejtën e tyre në ankesë.

1.5 Standardet e shturura në trajtimin e ankesave në shkallën e parë

Gjatë punës në terren, BIRN ka analizuar mënyrën e trajtimit të ankesave formale që punëtorët i kanë dorëzuar në Inspektoratin e Punës në shkallën e parë.

Nga 14 vendimet e analizuara, 11 prej tyre janë trajtuar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

BIRN ka gjetur se në vendimet e marra ka shpërputhje në përcaktimin e gjobave. Inspektorët kanë vendosur që në disa raste për shkeljen e njëjtë të shqiptojnë gjobë e në raste të ngjashme mos të shqiptojnë fare gjoba.

Prizren	Punëtor pa kontratë punë në 5 raste	Shkelje e Nenit 10 të ligjit të Punës	Shkelja 1: 100 -7,000	1000€	N/A	Jo
Prizren	Aksident në vend pune	Shkelja e nenit 7 par 1 dhe Nenit 20 par 1 të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë	Shkelja 1: 500 - 35,000 Shkelja 2: 500 - 20,000	500€	Jo	Jo
Ferizaj	Mos pagese e kontributeve personale	Refuzohet Ankesa si e pasafatshme	N/A	N/A	Po	N/A
Ferizaj	Mospagesa e pagës	Refuzohet Ankesa si e pasafatshme	N/A	N/A	Po	N/A
Mitrovicë	Shkelje në konkurs pune	Refuzohet Ankesa si e pasafatshme	N/A	N/A	Po	N/A
Mitrovicë	Punëtorë të mitur dhe mungesë e sigurisë	Shkelja e Nenit 7 par 4, Nenit 10, Nenit 20, Nenit 27 par 3, 32 par 1, dhe 55 të LP si dhe nenit 22 par 2 të LSSHP	Në katër raste 100-7000 një rast 100-10000 dhe një rast 500 - 20000	1000€	Po	Jo
Prishtinë	Mospagesa e pagës	Shkelje e Nenit 7 par 4 të Ligjit të Punës	Shkelja 1 : 100 - 7,000	Vërejtje	Po	Jo
Prishtinë	Ndërprerje e kundërligjshme e punës	Refuzohet Ankesa si e pabazuar	N/A	N/A	Po	N/A

¹⁴Raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës mbi numrin e të punësuarve, <https://ask.rks-gov.net/media/5554/afp-tm1-2020-finale.pdf>

¹⁵Artikulli i publikuar nga Radio Evropa e Lirë për numrin e punëtorëve në sektorin privat <https://www.evropaelire.org/a/vende-te-reja-punc-punetore/31770786.html>

Shkeljet e dispozitave të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë sanksionohen me gjoba të larta administrative.

Gjobat për shkelje të Ligjit të Punës janë të rregulluara me akt nënligjor, përkatësisht me Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e gjobave dhe shumave konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të Punës.

Ky Udhëzim Administrativ në nenin 8 ka përcaktuar se për çdo shkelje ligjore të konstatuar duhet të shqiptohen gjoba individuale dhe të njëjtat të mbledhen dhe të shqiptohet një gjobë unike.¹⁶

Diskrecioni i inspektorëve në shqiptimin e këtyre gjobave është tejet i madh. Sipas këtij udhëzuesi gjobat ndahen në pesë kategori dhe atë:

- Gjoba të cilat ndëshkohen prej 100-6,000 euro;
- Gjoba të cilat ndëshkohen prej 100-7,000 euro;
- Gjoba të cilat ndëshkohen prej 100-8,000 euro;
- Gjoba të cilat ndëshkohen prej 100-9,000 euro;
- Gjoba të cilat ndëshkohen prej 100-10,000 euro;

Analiza e vendimeve tregon se në asnjërin nga tetë vendimet e analizuara në të cilën janë shqiptuar gjoba nuk janë dhënë arsye për lartësinë e tyre. P.sh. në vendimin e dytë në Prizren i cili është paraqitur në tabelë për dy shkelje ligjore të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë është shqiptuar gjoba në lartësi prej 500 euro, ndonëse për dy shkeljet parashiheshin gjoba prej 500 deri në 35 mijë euro.

Prizren	Aksident në vend pune	Shkelje nenit 7 par 1 dhe Nenit 20 par 1 të Ligjit për Siguri shëndet në punë	Shkelja 1:500-35,000 Shkelja 2:500-20,000	500€	Jo	Jo
---------	-----------------------	---	--	------	----	----

Pra, në asnjërin nga vendimet e analizuara nuk është arsyetuar lartësia e gjobave.¹⁷

Gjobat për shkelje të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë janë edhe më të larta se sa ato për shkelje të Ligjit të Punës. Për dallim nga Ligji i Punës për të cilin gjobat janë paraparë me Udhëzim Administrativ, gjobat për shkelje të LSSHJ janë të përcaktuara në Ligj.

Për shkelje të dispozitave të këtij ligji janë paraparë gjashtë kategori gjobash dhe atë:

- Prej njëqind (100) deri pesëmijë (5,000) Euro;
- Prej pesëqind (500) deri në dhjetëmijë (10,000) Euro;
- Prej pesëqind (500) deri pesëmbëdhjetëmijë (15,000) Euro;
- Prej pesëqind (500) deri njëzetmijë (20,000) Euro;
- Prej pesëqind (500) deri njëzetepesëmijë (25,000) Euro;
- Prej pesëmijë (5.000) deri tridhjetepesëmijë (35,000) Euro;

Pra, diskrecioni i inspektorëve në shqiptimin e gjobave për shkeljen e këtyre dispozitave nuk është i rregulluar fare dhe një hapësirë kaq e gjerë nuk e përjashton mundësinë e keqpërdorimeve nga ana e inspektorëve të punës.

Mungesa e standardeve dhe përcaktimeve për gjobat tregon për një shpërputhje të madhe në Inspektorat në mënyrën se si trajtohen subjektet.


¹⁶ Neni 8 i Udhëzimit Administrativ për caktimin e Gjobave dhe Shumave konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të Punës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8160>

¹⁷ Rezultati nga analiza e vendimeve të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës.

1.6 Konstatimet e parregullsive dhe vonesave në shkallën e dytë

Gjatë analizimit të materialeve, BIRN ka siguruar të dhëna të cilat argumentojnë që shkalla e parë e trajtimit të ankesave në Inspektoratin e Punës ka kryer shkelje serioze të procedurave të shqiptimit të ndëshkimit. Të dhënat e siguruar nga shkalla e dytë e Inspektoratit tregojnë se vetëm 6.7% e vendimeve të shkallës së parë kanë qenë në rregull me procedurat nga mënyra e vendosjes tregohet se 93.3% e vendimeve anulohen ose kthehen në rishqyrtim.

Vendimet e shkallës së dytë gjatë vitit 2020 dhe 2021



Në vitin 2020, në shkallë të dytë janë paraqitur 218 ankesa, prej tyre 95 janë aprovuar, 31 janë kthyer në rivendosje ndërsa vetëm 41 janë refuzuar. Kjo nënkupton se në vetëm 41 raste vendimet e Inspektoratit në shkallë të parë kanë qenë në përputhje me Ligjin.¹⁸

Në vitin 2021, në shkallë të dytë janë paraqitur 1,633 ankesa të palëve kundër vendimeve të shkallës së parë, prej tyre 83 ankesa janë refuzuar si të pabazë, 798 ankesa janë aprovuar, 161 lëndë janë kthyer në rishqyrtim shkallës së parë.¹⁹

BIRN ka konstatuar se edhe gjatë trajtimit të ankesave nga shkalla e dytë ka probleme.

Për qëllime të këtij raporti janë analizuar 9 raste të trajtuara nga shkalla e dytë dhe aty janë konstatuar shkelje të afateve dhe çështje procedurale.²⁰

Analiza e këtyre nëntë vendimeve tregon se ankesat në këtë shkallë nuk trajtohen brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e Ligjit të Punës. Të dhënat e nxjerra nga këto aktvendime tregojnë se ankesa në shkallë të dytë zgjidhet nga dy deri në tre muaj pas paraqitjes, ndërsa Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative në nenin 133 parasheh se ankesa duhet të trajtohet brenda 30 ditëve.

¹⁸ Raporti vjetor i Inspektoratit të Punës për vitin 2020, <https://ip.rks-gov.net/ep-content/uploads/RAP-NARRATIV-I-IP-se-2020-002-compressed.pdf>

¹⁹ Raporti vjetor i Inspektoratit të Punës për vitin 2021, <https://ip.rks-gov.net/ep-content/uploads/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf>

²⁰ Rezultati nga analiza e vendimeve të shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës.

Një e dhënë tjetër e nxjerrë nga analiza e vendimeve në shkallë të dytë tregon se pjesa hyrëse nuk është në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Përkatësisht asnjëri nga nëntë vendimet e analizuar nuk e ka në pjesën hyrëse datën e nxjerrjes së vendimit.

Neni 47 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar qartë se çdo akt administrativ duhet të përmbajë :

- Pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes;²¹

Pra, data e nxjerrjes së aktvendimit nuk është detyrim fakultativ i organit administrativ që të vlerësojë nëse duhet të vendoset data e nxjerrjes së vendimit por është obligim ligjor i cili nuk mund të shmanget. Mungesa e datës së nxjerrjes së vendimeve mund të përbëjë arsye që vendimi të kthehet në rivendosje, pasi që gjykata gjatë shqyrtimit të konfliktit administrativ nuk mund të verifikojë nëse ankesa është paraqitur brenda fatit ligjor.

1.7 Paqartësia ligjore në vendimmarrjen në mes inspektoratit dhe gjykatave

Ndonëse janë vendosur mijëra lëndë sikurse në Inspektoratin e Punës ashtu edhe në sistemin gjyqësor, kompetencat e Inspektoratit për mbikëqyrjen e Ligjit të punës ishin të paqarta deri në fund të vitit 2022. Mijëra lëndë të vendosura nga Inspektorati i Punës janë prishur nga gjyqësori për shkak të tejkalimit të kompetencave.

Gjyqësori konsideronte se është i vetmi autoritet për të vendosur në lidhje me kërkesat e të punësuarve për pagat, vendimet disiplinore, ligjshmërinë e vendimeve, kthimin në punë dhe kërkesat e tjera materiale, të përcaktuara në Ligjin e Punës.

Për këtë arsye gjykatat në një numër të madh të vendimeve kishin konstatuar se Inspektorati i Punës është duke vendosur në mënyrë meritorë paralelisht me gjykatat për çështjet që lidhen me të drejtat nga marrëdhënia e punës duke e tejkaluar kështu juridiksionin që e ka.

Duke e pasur parasysh se një numër i madh i qytetarëve që presin vendimet e Inspektoratit të Punës po i humbin afatet ligjore për të paraqitur paditë në gjykatë, Gjykata Supreme e Kosovës me 4 shkurt të vitit 2021 e kishte referuar në Gjykatën Kushtetuese çështjen e kompetencave të Inspektoratit të Punës.²²

Përkatësisht instanca më e lartë e gjyqësorit ka kërkuar nga Kushtetuesja që të sqarojë nëse Inspektorati i Punës ka të drejtë të vendosë për kërkesat e punëtorëve lidhur me pagat, ligjshmërinë e vendimeve dhe kthimin në punë të punëtorëve.

Kërkesa e Gjykatës Supreme është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese në mënyrë që të qartësohen kompetencat ligjore të Inspektoratit të Punës me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore në rastet e kontesteve të punës.

Vetëm gjatë vitit 2022, në 16 raste për të cilat kanë vendosur gjykatat e rregullta, 11 padi janë aprovuar duke e prishur vendimin e Inspektoratit të Punës ose duke e kthyer çështjen në rishqyrtim, ndërsa vetëm 5 padi janë refuzuar si të pabazuara.

Për këtë kërkesë të Supremes është vendosur përfundimisht në javën e fundit të vitit 2022 nga Gjykata Kushtetuese.

Kushtetuesja i dha të drejtë përfundimisht Gjykatës Supreme pasi konstatoi se Inspektorati i Punës kundërligjshëm kishte zbatuar ligjin duke ndërhyrë në kompetencat e gjykatës. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese konstatoi se asnjë inspektorat nuk mund të ushtrojë funksione të natyrës gjyqësore, dhe se për kthimin në punë, kërkesat për pagat dhe ligjshmërinë e vendimeve vendos vetëm gjykata.

²¹ Neni 47 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12559>

²² Referimi i Gjykatës Supreme në Gjykatën Kushtetuese, i datës 4 shkurt 2021.


1.8 Dështimi për të ulur numrin e aksidenteve në punë

Siguria në vendin e punës është njëra nga aspektet më të rëndësishme të cilat i mbikëqyr Inspektorati i Punës. Siguria në vendin e punës në Kosovë është e rregulluar me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Ky Ligj përmban rregullat dhe obligimet për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimit të të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre.²³

Ligji ka përcaktuar në mënyrë të qartë obligimet e punëdhënësve e po ashtu edhe të punësuarve, mirëpo siguria dhe gjendja me aksidentet në vendin e punës në Kosovë vazhdon të jetë në nivel jo të kënaqshëm.

Në bazë të të dhënave zyrtare të Inspektoratit të Punës nga viti 2016 deri në vitin 2021 janë raportuar 787 aksidente në vendin e punës prej të cilave 78 kanë rezultuar me pasoja fatale për punëtorët.²⁴

Numri i aksidenteve në punë nga viti 2016-2021




Numër i madh i rasteve të aksidenteve me fatalitet shënohet edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022. Që nga janari e deri në korrik të vitit 2022 nga aksidentet në vendin e punës kanë pësuar pasoja fatale 11 persona.

Të dhënat ndër vite të Inspektoratit të Punës tregojnë se në vend që gjendja të shkojë duke u përmirësuar, ajo është keqësuar nga viti në vit. Tabela më poshtë tregon se çdo vit numri i aksidenteve në punë ka shënuar rritje.²⁵

²³ Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>

²⁴ Raporti i punës së Inspektoratit të Punës, publikuar për vitin 2021, <https://ip.rks-gov.net/ep-content/uploads/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf>

²⁵ Tabela e publikuar në raportin vjetor të Inspektoratit të Punës për vitin 2021, <https://ip.rks-gov.net/ep-content/uploads/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf>



Mirëpo numri i aksidenteve në vendin e punës i cili është raportuar ndër vite është larg numrit real të aksidenteve të cilat ndodhin.

Çdo ditë në qendrat spitalore dhe qendrat mjekësore të Kosovës paraqiten raste të lëndimeve, mirëpo mungesa e një mekanizmi të regjistrimit dhe raportimit të llojit të aksidentit ka bërë që jo çdo rast i lëndimit në punë të deklarohet.

Aktualisht vetëm lëndimet serioze dhe vdekjet në vendin e punës raportohen. Pra, nën deklarimi i aksidenteve në punë është shumë herë më i lartë se sa rastet të cilat përfundojnë në statistikat e Inspektoratit të Punës.

Nën deklarimi i aksidenteve konsiderohet si njëri nga problemet kryesore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë nga Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO). Ky institucion ndërkombëtar këtë fakt e ka theksuar në Profilin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë të hartuar për Kosovën në vitin 2021.²⁵

Gjendjen e rënduar të mungesës së sigurisë në vendin e punës e veçanërisht në sektorin e ndërtimit e tregon edhe aksioni i fundit i Inspektoratit të Punës i cili u zhvillua gjatë muajit shtator të vitit 2022.

Përgjatë gjithë muajit shtator, Inspektorati i Punës ka ndërmarrë veprime në drejtim të mbikëqyrjes së sigurisë në vendin e punës në bizneset e ndërtimit të cilat ndërtojnë në rajonin e Prishtinës. Me urdhër të Kryeinspektorit të Punës, Hekuran Nikçi, janë inspektuar 106 kantiere ndërtimi në rajonin e Prishtinës ku si rezultat në 40 prej tyre janë ndërprerë menjëherë punimet për shkak të mungesës së sigurisë, ndërsa në 33 kantiere të tjerë janë shqiptuar vërejtje dhe vetëm në dy raste gjoba. Pra, në 69% të rasteve të inspektuara janë hasur parregullsi dhe mungesë e sigurinë në punë. Ky numër tregon se mbi 1 mijë punëtorë që kanë qenë duke punuar kantieret e ndërtimit në rajonin e Prishtinës kanë deri në muajin shtator kanë qenë duke punuar në objekte të cilat nuk i plotësonin kushtet për punë.

²⁵ Tabela e publikuar në raportin vjetor të Inspektoratit të Punës për vitin 2021, <https://ip.rks-gov.net/ep-content/uploads/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf>

²⁶ Profili i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë i hartuar nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, publikuar për herë të parë në vitin 2021, https://www.ilo.org/etcmssp/groups/public/-/europe/-/ro-geneva/-/sro-budapest/documents/publication/etcms_797502.pdf

1.9 Rezultatet e dobëta në imponimin e zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë


Inspektorati i Punës nuk ka arritur t'i obligojë bizneset që të kryejnë vlerësimin e rrezikut në punë e poashtu certifikimin e stafit për të ofruar shërbime të tilla si dhe imponimin e obligimit ligjor për kontrolle mjekësore të punonjësve.

Me qëllim të parandalimit të rrezikut në vendin e punës, punëdhënësit janë të obliguar që të bëjnë vlerësimin e rrezikut. Ky obligim buron nga neni 16 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.²⁷

Sipas këtij Ligji, ky vlerësim duhet të bëhet nga profesionistë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. Pasi të kryhet procesi i vlerësimit të rrezikut, punëdhënësit obligohen të hartojnë dokumentin e vlerësimit të rrezikut dhe të ndërmarrin masat mbrojtëse të domosdoshme për sigurinë dhe shëndetin në punë të të punësuarve. Përpos dokumentit për vlerësimin e rrezikut, punëdhënësi është i detyruar të mbajë evidencën për lëndime në punë, sëmundjet profesionale dhe të pajisë të lënduarin me flete lëndim në vend të punës.

Dënimi për kompanitë të cilat nuk e kryejnë vlerësimin e rrezikut është i lartë dhe parashihet prej 500 deri në 25 mijë euro e në disa raste mund të shkojë deri në 35 mijë euro.


Të dhënat e mbledhura nga Sekretariati i Komisionit për Siguri dhe Shëndet në Punë tregojnë se numri i bizneseve që e kanë kryer vlerësimin e rrezikut në vendin e punës është i ulët. Vetëm 1,740 biznese në Kosovë e kanë bërë vlerësimin e rrezikut në vendin e punës përderisa numri i bizneseve në Kosovë është mbi 112 mijë.²⁸



²⁷ Neni 16 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, "Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë dhe ekspozimin e të punësuarve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës".

²⁸ Statistikat e nxjerra nga përgjigjet e Sekretariati i Komisionit për Siguri dhe Shëndet në Punë.

Vlerësimi i rrezikut në punë përgjatë viteve



Këto të dhëna dëshmojnë trende të uljes së numrit të bizneseve që janë duke e përmbushur këtë obligim. Në vitin 2019 Inspektorati kishte arritur të impononte zbatimin e këtij rregulli në 622 raste ndërsa kjo shifër u ul në 442 gjatë vitit 2021.

Mungesa e raportit mbi rrezikun në vendin e punës për bizneset paraqet një ambient jo të sigurt të punës dhe si pasojë aksidentet në vendin e punës mund të jenë të shpeshta.

1.9.1 Mungesa e specialistëve dhe ekspertëve për siguri në punë

Për një ambient më të sigurt dhe të shëndetshëm të punës është paraparë caktimi i profesionistëve si persona përgjegjës ose angazhimi i personave apo kompanive për shërbime të specializuara.

Neni 10 i Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në punë ka përcaktuar se punëdhënësit duhet të caktojnë një person përgjegjës të certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Sipas ligjit, punëdhënësi i cili punëson deri në pesëdhjetë (50) të punësuar, nëse është i aftë/kompetent, mund të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin e masave të sigurisë në punë nëse është i certifikuar. Ndërsa punëdhënësi i cili punëson mbi pesëdhjetë (50) e më pak se dyqindpesëdhjetë (250) të punësuar, është i detyruar të caktojë një ekspert për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë. Kurse punëdhënësi i cili punëson më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) të punësuar duhet të angazhojë një (1) ose më shumë ekspertë për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.²⁹

Në Kosovë deri më tani janë certifikuar 150 specialistë themelorë, 60 ekspertë të kualifikuar dhe 87 specialistë të avancuar për sigurinë dhe shëndetin në punë. Ndërkaq për të ofruar trajnime për siguri dhe shëndet në punë janë të licencuar vetëm 37 trajnerë.³⁰

Përveç ekspertëve të certifikuar për ofrimin e shërbimeve për shëndet dhe siguri në vendin e punës janë të licencuara edhe 20 kompani të cilat ofrojnë shërbime të kësaj natyre për bizneset.³¹

Numri i tyre vazhdon të jetë i ulët në krahasim me numrin e bizneseve në të gjithë vendin. Vetëm në Komunën e Prishtinës llogaritet të jenë mbi 50 mijë biznese aktive, një pjesë e madhe e tyre obligohen të respektojnë rregullën për angazhimin e personave përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, mirëpo një gjë e tillë është vështirë e arritshme pa pasur rritje të numrit të inspektimeve për siguri dhe shëndet në punë.

1.9.2 Mungesa e kontroleve mjekësore

Kontrollimi mjekësor i të punësuarve është një tjetër obligim ligjor i punëdhënësve. Sipas Ligjit për Shëndet dhe Siguri në Punë, punëdhënësi është i detyruar t'u sigurojë të punësuarve kontrole mjekësore në institucionet shëndetësore të licencuara për shërbime nga mjekësia e punës. Këtë duhet ta bëjë së paku një herë në tri vjet.

Pra, punëtorët në mënyrë që të zhvillojnë aktivitetin e tyre duhet që të pajisen me certifikatën mjekësore e cila vërteton se janë të aftë për punë të caktuar. Vendimi nëse një punëtor është i aftë ose i paaftë për një punë të caktuar duhet të merret nga një mjek i specializuar në mjekësinë e punës i cili mban një certifikatë të mjekut të punës.

Mirëpo ky obligim nuk është se po zbatohet siç duhet në vendin tonë. Raporti i Zyrës Ndërkombëtare të Punës për Kosovën ka konstatuar se në praktikë, sistemi i mbikëqyrjes mjekësore të punëtorëve është joefektiv.³² Ky raport pos tjerash thekson se Inspektorati i Punës nuk po mbikëqyr në mënyrë adekuate zbatimin e mbikëqyrjes shëndetësore në nivelin e ndërmarrjes.

Ky raport i ILO-s e konsideron si shqetësues edhe numrin e vogël të mjekëve të punës. Sipas ILO në qoftë se Kosova nuk trajnon mjekë të rinj të punës, Kosova nuk do të ketë një numër të mjaftueshëm të mjekëve të punës për të kryer ekzaminime mjekësore për të gjithë punëtorët.

Në praktikë, mbikëqyrja shëndetësore në vendin e punës sigurohet nga dy institucione të mjekësisë së punës, Instituti i Mjekësisë së Punës i vendosur në Obiliq dhe Instituti i Mjekësisë së Punës në Gjakovë si dhe institucionet private mjekësore. Aktualisht nuk ka të dhëna për nivelin e shëndetësisë në vendin e punës, pasi asnjë institucion nuk i mbledh të dhënat se sa certifikata mjekësore që vlerësojnë shëndetin e punëtorëve në vendin e punës lëshohen brenda një viti në Kosovë.

²⁹ Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë, neni 10.

³⁰ Statistikat e nxjerra nga përgjigjet e Sekretariatit i Komisionit për Siguri dhe Shëndet në Punë.

³¹ Statistikat e nxjerra nga përgjigjet e Sekretariatit i Komisionit për Siguri dhe Shëndet në Punë.

³² Raporti i ILO-së, publikuar në vitin 2021, https://www.ilo.org/ëcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/ëcms_797502.pdf

Instituti i Mjekësisë së Punës me seli në Gjakovë, gjatë këtij viti ka lëshuar vetëm 44 certifikata mjekësore për punëtorë, ndërsa në vitin 2021 numri i certifikatave të lëshuara ishte vetëm 69.

Përveç numrit të vogël të certifikatave të lëshuara nga ky institucion, shqetësuese është edhe mungesa e mjekëve të punës. Në këtë institucion aktualisht është vetëm një mjek i cili ka arritur pensionimin, por që në mungesë të mjekëve të tillë është angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm me gjysmë orari.³³

2. Trajtimi gjyqësor i çështjeve të punës

Sistemi i drejtësisë është një nga hallkat e rëndësishme që siguron ndëshkueshmëri për shkelësit dhe drejtësi për viktimat e shkeljeve dhe diskriminimit në punë.

Gjykatat trajtojnë çështje administrative, civile dhe penale të rasteve të punës ndërsa prokuroria e shtetit luan rol themeltar në hetimin e veprave penale që lidhen me çështjet e punës.

Hulumtimi i BIRN konstaton vonesa të paarsyeshme të sistemit të drejtësisë në zbatimin e obligimeve ligjore, mungesë të standardeve procedurale, dënime të buta dhe standarde të dyfishta në trajtimin e çështjeve nga sistemi i drejtësisë. BIRN ka gjetur se sistemi i drejtësisë ka dështuar në arritjen e standardeve në:

- Zbatimin e standardit kohor për gjykim të arsyeshëm
- Hetimet me kohë të denoncimeve për shkelje të të drejtave të punëtorëve

2.1 Dështimi i gjykatave për zbatimin e standardit për gjykim në kohë të arsyeshme


Kontestet nga marrëdhënia e punës ngriten nga punëtorët apo bizneset në rastet kur ka mosmarrëveshje për çështjet e zbatimit të kontratës së punës apo largimit nga puna. Këto raste sipas ligjit trajtohen me prioritet nga gjykatat e Kosovës.

Statistikat tregojnë që sistemi i drejtësisë është kolaps sa i përket trajtimit të këtyre rasteve. Në tri vitet e fundit 2018-2021 vetëm 35.6% e këtyre lëndëve janë zgjidhur.

³³ Të dhënat nga përgjigjja e Institutit të Punës në Gjakovë.

³⁴ Të dhënat e nxjerra nga databaza "Transparenca dhe llogaridhënia në sistemin e drejtësisë, <https://no-fakenës.com/kallxo-com/>

Trajtimi i 11,834 kontesteve të punës gjatë viteve 2016-2018



Grafiku tregon se për 3 vite në sistemin gjyqësor kanë qenë duke pritur për zgjidhje plotë 11,834 lëndë, ndërkaq me vendim gjyqësor janë gjykuar vetëm 35.6% e tyre apo vetëm 4,215 raste të kontesteve të punës.

Këto të dhëna tregojnë që punëtorët nuk kanë arritur të marrin përgjigje për paditë e tyre.

BIRN ka analizuar edhe mënyrën e zgjedhjes së këtyre rasteve.

Të dhënat tregojnë se në pjesën më të madhe punëtorët kanë pasur të drejtë në çështjet që janë ngritur në gjykatë.

Nga 4,215 raste për të cilat është vendosur në mënyrë meritore në 2,612 raste fitimtarë kanë dalë punëtorët ndërkaq në 1,005 raste padia u është refuzuar, kurse 598 raste janë zgjidhur në formë tjetër përmes marrëveshjes gjyqësore apo formave të tjera.

Kjo e dhënë tregon se shkelja e konstatuar e të drejtave të punëtorëve nga gjykata është në nivel të lartë.

2.2 Neglizhenca në trajtimin e rasteve penale

Në rastet e diskriminimit, shkeljes së të drejtave të punëtorëve apo lëndimeve në punë rastet trajtohen nga sistemi penal i vendit. Inspektorë, policë, mjekë, prokurorë, mbrojtës të viktimave, avokatë e gjykatës janë të thirrur që me profesionalizëm të hetojnë dhe gjykojnë shkeljet e dënueshme të të drejtave të punëtorëve.

BIRN ka analizuar 27 dosje penale të cilat janë gjykuar në shtatë gjykatat themelore të Republikës së Kosovës.³⁵

Gjetjet nga kjo analizë tregojnë për:

- Vonesa të paarsyeshme në trajtimin e kallëzimeve penale;
- Hetime të tej zgjatura;
- Vonesa të trajtimit të akuzave;
- Dënime të buta ndaj kryesve të veprave penale;
- Llogaritje jashtë standardeve të rrethanave të kryerjes së veprës.

Kallëzimi penal si mjet përmes së cilit inicohet procedura hetimore duhet të trajtohet nga Prokurori i shtetit brenda afatit 30 ditor. Në 10 nga 27 rastet e analizuara është konstatuar vonesë në trajtimin e kallëzimeve penale. Në shumicën e këtyre rasteve trajtimi është vonuar nga 2 deri në 4 muaj përderisa ka pasur rast kur kallëzimi penal është trajtuar me 2 vite vonesë, si Rasti 2 në Mitrovicë, por ka raste kur kallëzimi është trajtuar me 1 vit vonesë sikurse Rasti 4 në Mitrovicë dhe Rasti 2 në Prishtinë.

Ndërkaq në 17 rastet e tjera është respektuar afati 30 ditor i përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale për trajtimin e kallëzimit penal.

Përpos vonesave në trajtimin e kallëzimeve penale mbi bazën e analizës së 27 vendimeve gjyqësore vonesa janë konstatuar edhe në trajtimin e aktakuzave.

Sipas Kodit të Procedurës Penale, pas ngritjes së aktakuzës brenda afatit 30 ditor duhet të caktohet dhe mbahet seanca e shqyrtimit fillestar. Mirëpo të dhënat e nxjerra nga analiza tregojnë se ky afat është respektuar në vetëm tre raste nga 27 sa janë analizuar. Pra, vonesat në këtë fazë të procedurës janë pothuajse në secilin rast.

Në 7 raste, caktimi i shqyrtimit fillestar të aktakuzës është vonuar mbi 2 vite, ndërsa në 6 raste vonesa e ka tejkaluar periudhën prej 1 viti. Pra mbi 1 vit vonesë në caktimin e shqyrtimit fillestar është konstatuar në 13 prej 27 rasteve të analizuara.

Pas shqyrtimit të aktakuzës dhe vlerësimit të provave materiale dhe jo materiale vjen faza e nxjerrjes së vendimit gjyqësor. Kjo fazë nënkupton gjykimin e personit i cili akuzohet se ka kryer veprën penale. Në këtë rast i akuzuari ose shpallet fajtor ose lirohet nga akuza. Në rastet kur vendimi është fajësues, gjyqtari ose trupi gjykues duhet të mblidhet dhe të vendosë për shqiptimin e dënimit.

Një fazë me rëndësi para vendimit mbi dënim është vlerësimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese të cilat duhet të nxirren nga rrethanat e rastet në mënyrë që lartësia e dënimit të jetë e arsyetuar.


Në Kodin e Procedurës Penale janë të përcaktuara rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat merren për bazë në matjen e dënimit. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore mbi bazën e të cilit gjyqtarët duhet të arsyetojnë lartësinë e dënimit të cilën e shqiptojnë.³⁶

BIRN ka analizuar 20 vendimet dënuese të shqiptuara nga gjykatat e rregullta nëse të njëjtat kanë qenë në përputhje me udhëzuesin e politikës ndëshkimore.

³⁵ Të dhënat e nxjerra nga 27 dosjet penale të trajtuara nga Gjykatat Themelore.

³⁶ Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore, shkurt 2018, https://supreme.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/legalOpinions/Udhezues%20per%20Politiken%20ndeshkimore_Shkurt%202018.pdf

Vendimet e Gjykatave



Nga këto aktgjykime të analizuara, katër raste kanë qenë me akuzën për pasoja fatale të punëtorit si pasojë e mungesës së sigurisë në punë.

Në këto raste dënimi parashihet të shqiptohet nga 1 deri në 10 vite burgim, mirëpo analiza tregon se në dy raste, kryesit janë dënuar me burgim me kusht e në dy raste të tjera me dënim me burgim efektiv.

Në dosjet e analizuara është konstatuar se vetëm në një rast është kërkuar paraburgimi për kryesit e veprave.

Analiza e BIRN zbulon edhe probleme të tjera dhe diskrepancë në mes gjykatave.

2.2.1 Trajtimi i Rasteve nga Gjykata Themelore dhe Prokuroria në Pejë

Në rrethin gjyqësor të Pejës janë analizuar katër raste. Dy prej këtyre rasteve janë gjykuar, ku njëri ka përfunduar me dënim prej 1 viti burgim me kusht, ndërsa tjetri ka përfunduar në procedurë të ndërmjetësimit. Dy rastet e tjera nuk janë duke u gjykuar dhe për to nuk është vendosur akoma.

Në çështjet e trajtuara nga Gjykata e Pejës vërehen vonesa në trajtimin e kallëzimeve penale e po ashtu vonesa në trajtimin e aktakuzave. Madje në dy rastet që janë në gjykim e sipër, shqyrtimi fillestar i aktakuzës është caktuar me mbi 1 vit vonesë. Të dhënat e nxjerra nga analiza tregojnë se nga katër punëtorët që kanë qenë viktimat të këtyre rasteve vetëm njëri nga ta ka pasur të nënshkruar kontratë pune.

GJ.TH. PEJË	Kur ka ndodhur rasti	Natyra e veprës	Dënimi i paraparë	Rrethana lehtësuese	Rrethana rënduese	Dënimi i shqiptuar	A është në përputhje me udhëzuesin e Gjykatës Supreme	A është bërë ekspertiza mjekoligjore	A është hartuar me kohë raporti nga IP	A është dorëzuar me kohë Kallzimi Penal	A është trajtuar me kohë kallzimi penal	Kur është ngritë aktakuza	A është caktuar me kohë shqyrtimi i aktakuzës	A ka pasur paraburgim	Puntori i pajisur me kontratë pune	
1	P.nr.843/18	12 shkurt 2017	Neni 367 par 4 lidhur me par.2 Lendim	1-10 vite	6	1	1 vit burg me kusht	Jo	Po	Po	10 muaj pas rastit	Jo (10 muaj me vonesë)	5 nëntor 2018	Jo (2 muaj me vonesë)	Jo	Jo
2	P.nr.889/20	7 maj 2019	Neni 358 par 3	Deri në 3 vite	N/A	N/A	Ndermjetsim	Po	Po	Jo (2 muaj pas rastit)	11 dite pas rastit	Jo (5 muaj me vonesë)	4 dhjetor 2020	Jo (2 muaj me vonesë)	Jo	Po
3	PP.111052/20	26 nëntor 2019	Neni 358 par 5 lidhur me par 3	Deri në 5 vite	N/A	N/A	N/A	Po	Po	Jo (2 muaj pas rastit)	8 muaj pas rastit	Jo (2 muaj me vonesë)	8 dhjetor 2020	1 vit e 10 muaj me vonesë	Jo	Jo
4	P.nr.251/20	30 nëntor 2019	Neni 358 par 4	1-10 vite	N/A	N/A	N/A	N/A	Po	Po (brenda muajt)	15 dite pas rastit	Jo (2 muaj me vonesë)	28 shkurt 2020	Nuk është caktuar akoma	Jo	Jo

2.2.2 Trajtimi i Rasteve nga Gjykata Themelore dhe Prokuroria në Gjakovë

Në rrethin gjyqësor të Gjakovës janë analizuar katër raste. Të dhënat nga kjo gjykatë tregojnë se për të katër rastet janë shqiptuar dënime me gjoba pasi dënimi me burgim prej 6 muajve është shndërruar në dënim me gjobë sipas mundësisë që e parasheh Kodi Penal.

Në çështjet e trajtuara nga Gjykata e Pejës vërehen vonesa në trajtimin e kallëzimeve penale e po ashtu vonesa në trajtimin e aktakuzave. Në asnjërin prej këtyre rasteve vendimi nuk ka qenë në përputhje me Udhëzuesin e Politikës Ndëshkimore. Në këto raste, viktimat kanë qenë dy punëtorë ku njëri nga ta nuk ka pasur kontratë pune.

GJ.TH. GJAKOVË	Kur ka ndodhur rasti	Natyra e veprës	Dënimi i paraparë	Rrethana lehtësuese	Rrethana rënduese	Dënimi i shqiptuar	A është në përputhje me udhëzuesin e Gjykatës Supreme	A është bërë ekspertiza mjekoligjore	A është hartuar me kohë raporti nga IP	A është dorëzuar me kohë Kallzimi Penal	A është trajtuar me kohë kallzimi penal	Kur është ngritë aktakuza	A është caktuar me kohë shqyrtimi i aktakuzës	A ka pasur paraburgim	Puntori i pajisur me kontratë pune	
1	P.nr.87/19	3 tetor 2018	Neni 367 par 2 lidhur me par 3	Deri në 3 vite	10	0	700€	Jo	Po	Po brenda 8 diteve	3 muaj pasi ka ndodhe rasti	Po	17 prill 2019	Jo (8 muaj me vonesë)	Jo	N/A
2	P.nr.597/21	24 gusht 2020	Neni 358 par 5 lidhur me par 3	Deri në 5 vite	13	0	1000€	Jo	Po	Po brenda 3 javeve	8 muaj pasi ka ndodhe rasti	Po	18 maj 2021	Jo (2 muaj me vonesë)	Jo	Po
3	P.nr.185/19	5 shkurt 2019	Neni 367 par 4 lidhur me par 3	1-10 vite burgim	10	0	3000€	Jo	Po	Po brenda 2 diteve	4 muaj pasi ka ndodhe rasti	Jo (3 muaj pas kallximit penal)	23 gusht 2019	Jo (14 muaj me vonesë)	Jo	N/A
4	P.nr.594/21	31 mars 2021	Neni 358 par 5 lidhur me par 3	Deri në 5 vite	13	0	700€	Jo	Po	Po brenda 3 javeve	3 muaj pasi ka ndodhe rasti	3 muaj pasi ka ndodhe rasti	22 nëntor 2021	Jo (2 muaj me vonesë)	Jo	Jo

2.2.3 Trajtimi i Rasteve nga Gjykata Themelore dhe Prokuroria në Prishtinë

Në rrethin gjyqësor të Prishtinës janë analizuar katër raste. Të dhënat tregojnë se në këtë gjykatë gjykimi ka përfunduar në dy raste ndërsa dy rastet e tjera janë në pritje për t'u trajtuar. Në njërin nga rastet e vendosura i akuzuari është dënuar me gjobë ndërsa në tjetrin me burgim të kushtëzuar. Kallëzimet penale në tre raste janë trajtuar me kohë përderisa në njërin nga ta është dashur mbi 1 vit që të merret rasti në trajtim. Ndryshe nga Prokuroria, Gjykata në të katër rastet i ka shkëlur afatet ligjore pasi i ka caktuar seancat për shqyrtimin e akuzës me të paktën 1 vit vonesë.

Viktimat në dy raste kanë pasur kontrata pune, ndërsa në dy raste nuk kanë qenë punëtorë.

GJ.TH. GJAKOVË	Kur ka ndodhur rasti	Natyrë e veprës	Dënimi i paraparë	Rrethana lehtësuese	Rrethana rënduese	Dënimi i shqiptuar	A është në përputhje me udhëzuesin e Gjykatës Supreme	A është bërë ekspertiza mjekoligjore	A është hartuar me kohë raporti nga IP	A është dorëzuar me kohë Kallëzimi Penal	A është trajtuar me kohë kallëzimi penal	Kur është ngritë aktakuza	A është caktuar me kohë shqyrtimi i aktakuzës	A ka pasur paraburgim	Puntori i pajisur me kontratë pune	
1	Rnr.101/20	18 qershor 2012	Neni 358 par 5 lidhur me par 3	Deri në 5 vite	5	1	1500€	Jo	Po	Nuk është ftu fare'	Po	Po	29 tetor 2013	Jo (Mbi 2 vite me vonesë)	Jo	N/A
2	PP/15642/18	15 korrik 2018	Neni 367 par 5 lidhur me par 3	Deri në 5 vite	N/A	N/A	N/A	N/A	Po	Po brenda 15 diteve	2 muaj pasi ka ndodh rasti	Jo (1 vit me vonesë)	20 shkurt 2020	Jo (Kanë kaluar 2 vite 9 muaj)	Jo	Po
3	PP/13891/2018	3 shkurt 2018	Neni 367 par 3	Deri në 3 vite	N/A	N/A	N/A	N/A	Po	Po brenda muajit	4 muaj pasi ka ndodhë rasti	Po	10 nëntor 2020	Jo (Kanë kaluar 2 vite)	Jo	N/A
4	Rnr.5494/2017	6 mars 2017	Neni 367 par 2 lidhur me par 7	1 - 8 vite	1	0	2 vite me kusht	Jo	Po	Nuk është ftu fare'	Po brenda dite	Po	17 nëntor 2017	Jo (1 vit e 4 muaj me vonesë)	Jo	Po

2.2.4 Trajtimi i Rasteve nga Gjykata Themelore dhe Prokuroria në Mitrovicë

Në rrethin gjyqësor të Mitrovicës janë analizuar katër raste. Gjykata në Mitrovicë është ndër të vetmet që ka shqiptuar dënim me burgim efektiv dhe ndër të vetmet që ka shqiptuar dënime në pajtim me Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore. Në 2 raste janë shqiptuar dënime me burgim, një rast dënim me gjobë dhe një rast dënim me kusht. Ndërsa puna e prokurorisë në këtë rajon është karakterizuar në dy raste me vonesa në trajtimin e kallëzimeve penale të cilat e tejkalonin afatin ligjor për 1 vit. Në këtë rajon dy nga viktimat e rasteve të lëndimeve në punë kanë pasur kontrata pune e dy të tjerë nuk kanë pasur.

GJ.TH. MITROVICË	Kur ka ndodhur rasti	Natyrë e veprës	Dënimi i paraparë	Rrethana lehtësuese	Rrethana rënduese	Dënimi i shqiptuar	A është në përputhje me udhëzuesin e Gjykatës Supreme	A është bërë ekspertiza mjekoligjore	A është hartuar me kohë raporti nga IP	A është dorëzuar me kohë Kallëzimi Penal	A është trajtuar me kohë kallëzimi penal	Kur është ngritë aktakuza	A është caktuar me kohë shqyrtimi i aktakuzës	A ka pasur paraburgim	Puntori i pajisur me kontratë pune	
1	Rnr.668/2020	8 korrik 2018	Neni 367 par 5	1-5 vite	3	2	10 muaj burg me kusht	Po	Po	Nuk ka pas	2 muaj pas rastit	Po	3 nëntor 2020	Jo (2 muaj me vonesë)	Jo	Jo
2	Rnr.860/2016	22 shtator 2014	Neni 365 par 6	Deri në 3 vite	3	3	9 muaj burg	Po	Po	Jo (2 muaj e gjysmë pas rastit)	4 muaj pas rastit	Jo (2 vite pasi është paraqit kallëzimi)	19 dhjetor 2016	Po	Jo	Po
3	Rnr.647/2017	11 dhjetor 2014	Neni 368 par 5	1 deri në 5 vite	5	3	1 vit e 6 muaj burg	Po	Po	Po	8 muaj pas rastit	Po	23 nëntor 2017	Jo (reth 2 vite me vonesë)	Jo	Po
4	Rnr.499/2016	9 mars 2013	Neni 367 par 5	1-5 vite	6	1	6 muaj kthyer në 2000 euro	Jo	Po	Po	3 muaj pasi ka ndodhë rasti	Jo (1 vite me vonesë)	20 qershor 2016	Jo (reth 2 vite me vonesë)	Jo	Jo

2.2.5 Trajtimi i Rasteve nga Gjykata Themelore dhe Prokuroria në Ferizaj

Në rrethin gjyqësor në Ferizaj janë analizuar tre raste gjyqësore, njëri nga ta ka qenë rast me fatalitet ku i akuzuar ka qenë pronari i kompanisë. Rasti i fatalitetit është dënuar me 10 muaj burgim efektiv ndërsa dy rastet e tjera janë ndëshkuar njëri me gjobë e tjetri me burgim të kushtëzuar.

Puna e prokurorisë në këto tre raste tregon se kallëzimet penale nuk janë trajtuar me kohë, ndërsa akuzat në dy raste janë trajtuar me vonesë nga Gjykata. Të dhënat tregojnë se vetëm në një rast vendimi ka qenë në përputhje me Udhëzuesin e Politikës Ndëshkimore dhe vetëm në një rast viktimja ka pasur kontratë pune.

GJ.TH. FERIZAJ	Kur ka ndodhur rasti	Natyrë e veprës	Dënimi i paraparë	Rrethana lehtësuese	Rrethana rënduese	Dënimi i shqiptuar	A është në përputhje me udhëzuesin e Gjykatës Supreme	A është bërë ekspertiza mjekoligjore	A është hartuar me kohë raporti nga IP	A është dorëzuar me kohë Kallëzimi Penal	A është trajtuar me kohë kallëzimi penal	Kur është ngritë aktakuza	A është caktuar me kohë shqyrtimi i aktakuzës	A ka pasur paraburgim	Puntori i pajisur me kontratë pune	
1	Pnr.298/2019	29 nëntor 2014	Neni 367 par.7 lidhur me par.3	1-8 vite	5	3	10 muaj burgim	Jo	Po	Po	3 javë pasi ka ndodhë rasti	Jo (3 muaj me vonesë)	3 dhjetor 2015	Jo (Mbi 2 vite me vonesë)	Jo	Jo
2	Pnr.89/2018	13 maj 2016	Neni 367 par.5 lidhur me par.3	Deri në 5 vite	4	4	2500 euro	Jo	Po	Po	5 muaj pasi ka ndodhë rasti	Po	17 janar 2018	Jo (Kanë kaluar 2 vite 9 muaj)	Jo	Po
3	Pnr.21/2019	10 tetor 2018	Neni 367 par.2 lidhur me par.3	Deri në 3 vite	6	0	4 muaj burg me kusht	Po	Po	Po	1 muaj pasi ka ndodhë rasti	Po	25 janar 2019	Jo (Kanë kaluar 2 vite)	Jo	N/A

2.2.6 Trajtimi i Rasteve nga Gjykata Themelore dhe Prokuroria në Prizren

Në rrethin gjyqësor në Prizren janë analizuar katër raste. Të dhënat tregojnë se në një rast është shqiptuar dënim me burg, në një rast me gjobë dhe në një rast me burgim të kushtëzuar. Në Prizren në dy raste dënimi ka qenë në përputhje me Udhëzuesin për Politikë Ndëshkimore.

Prokuroria në Prizren i ka trajtuar me kohë të katër kallëzimet penale, ndërsa Gjykata në tre raste ka shkelur afatet ligjore duke i tejkaluar për më shumë se një vit. Në dy rastet e analizuara viktimat kanë qenë punëtorë, njëri nga ta nuk ka pasur kontratë pune.

GJ.TH. PRIZREN	Kur ka ndodhur rasti	Natyrë e veprës	Dënimi i paraparë	Rrethana lehtësuese	Rrethana rënduese	Dënimi i shqiptuar	A është në përputhje me udhëzuesin e Gjykatës Supreme	A është bërë ekspertiza mjekoligjore	A është hartuar me kohë raporti nga IP	A është dorëzuar me kohë Kallëzimi Penal	A është trajtuar me kohë kallëzimi penal	Kur është ngritë aktakuza	A është caktuar me kohë shqyrtimi i aktakuzës	A ka pasur paraburgim	Puntori i pajisur me kontratë pune	
1	Pnr.268/2021	05.02.2020	219 par.1 të KPRK-së	Gjohë ose me burgim deri në 2 vite	1	0	500€ gjohë	Po	Nuk ka pasur nevojë	Nuk ka raport	Kallëzimin e ka dorëzuar pala	Po	17/11/2021	Jo, 9 muaj me vonesë	Jo	N/A
2	Pnr.454/2019	19/07/2018	367 par.7 lidhur me par.3	1 deri në 8 vite burg	N/A	N/A	1 vit burgim me kusht	Po	Po	Nuk ka raport	6 muaj pasi ka ndodhë rasti	Po	4/12/2019	Jo, afër 2 muaj pas ngritjes së aktakuzës	Jo	Jo
3	Pnr.469/2019	29/05/2012	367 par.2 lidhur me par.3 dhe par.4	Deri në 3 vite	N/A	N/A	N/A	N/A	Po	Nuk ka raport	8 muaj pasi ka ndodhë rasti	Po	24/03/2014	Jo (mbi 2 vite me vonesë)	Jo	Po
4	Pnr.585/18	12/10/2017	367 par.7 lidhur me par.3	1 - 8 vite	1	0	2 vjet burg	Jo	Po	Po (brenda 24 orëve)	Po (brenda 24 orëve)	Po	16/04/2018	Po	Po	N/A

2.2.7 Trajtimi i Rasteve nga Gjykata Themelore dhe Prokuroria në Gjilan

Në rrethin gjyqësor në Gjilan janë analizuar katër raste. Të dhënat nga kjo Gjykatë tregojnë se për të katër rastet janë shqiptuar dënime me gjoba pasi dënimi me burgim prej 6 muajve është shndërruar në dënim me gjobë sipas mundësisë që e parasheh Kodi Penal. Në çështjet e trajtuara nga Gjykata e Gjilanit vërehen vonesa në trajtimin e kallëzimeve penale e po ashtu vonesa në trajtimin e aktakuzave.

Në tre raste të Gjykatës në Gjilan nuk është zbatuar Udhëzuesi i Politikës Ndëshkimore, dhe në dy raste viktimat kanë qenë punëtorët të cilët kanë qenë të pajisur me kontrata pune.

GJ.TH. GJILAN	Kur ka ndodhur rasti	Natyrë e veprës	Dënimi i paraparë	Rrethana lehtësuese	Rrethana rënduese	Dënimi i shqiptuar	A është në përputhje me udhëzuesin e Gjykatës Supreme	A është bërë ekspertiza mjekoligjore	A është hartuar me kohë raporti nga IP	A është dorëzuar me kohë Kallëzimi Penal	A është trajtuar me kohë kallëzimi penal	Kur është ngritë aktakuza	A është caktuar me kohë shqyrtimi i aktakuzës	A ka pasur paraburgim	Puntori i palisur me kontratë pune	
1	P.nr.998/2019	26/12/2019	Neni 367 par 7 lidhur me par 3	Deri 5 vjet burg	6	0	600 euro gjobë	Jo	Po	Po-brenda 2 jave	2 muaj e 9 ditë pasi ka ndodhë rasti	Po-brenda 24 oreve	28 prill 2017	Jo (Mbi 2 vite me vonesë)	Jo	Jo
2	P.nr. 899/18	30/01/2018	Neni 367 par 5 lidhur me par 3	1-8 vjet	3	2	1800 euro gjobë	Po	Po	Po	2 muaj pasi ka ndodhë rasti	Po-brenda 30 ditëve	10 shkurt 2018	Jo (Kanë kaluar 2 vite 9 muaj)	Jo	Po
3	P.nr.162/19	21/11/2018	Neni 367 par 2 lidhur me par 3	6 muaj deri 5 vjet	6	0	1300 euro gjobë	Jo	N/A	Po	2 muaj pasi ka ndodhë rasti	Po-brenda 30 ditëve	13 shkurt 2019	Jo (1 vjet e 5 muaj me vonesë)	Jo	N/A
4	P.nr.392/2019	9/5/2015	Neni 367 par 2 lidhur me par 7	Deri 5 vjet burg	4	1	2000 euro gjobë	Jo	Po	Jo	Jo (1 vit e 9 muaj pasi ka ndodhë rasti)	Jo	19 prill 2019	Jo (9 muaj me vonesë)	Jo	Po

Të dhënat e analizuar nga sistemi i drejtësisë tregojnë për shpërputhje në mënyrën e vendimmarrjes shpërputhje në respektimin e afateve kohore mënyrën e zbatimit të politikës ndëshkimore.

3. Rekomandimet

- Qeveria e Kosovës të përfundojë procesin e hartimit të Ligjit të ri të Punës
- Qeveria e Kosovës të sigurojë mbështetje për rritjen e strukturës kadrovike të Inspektoratit të Punës me theks të veçantë shtimin e numrit të inspektorëve
- Shtimi i kapaciteteve të Inspektoratit të kryhet duke e zbatuar standardin gjinor
- Inspektorati i Punës të investojë në pajisje teknologjike për të afirmuar raportimin dhe menaxhimin e rasteve të trajtuara
- Inspektorati i Punës të trajtojë me seriozitet cilësinë e vendimeve të shkallës së parë dhe të ndër marrë masa që shkeljet e konstatuara nga shkalla e dytë të mos përsëriten
- Inspektorati i Punës të krijojë standarde në shqiptimin e gjobave dhe ndëshkimeve për shkeljet
- Inspektorati i Punës të shtojë angazhimin për zbatimin e ligjit për shëndetin dhe sigurinë në punë
- Inspektorati i Punës të reformojë procedurën dhe të nisë dërgimin e kallëzimeve penale në Prokurorinë e Shtetit
- Inspektorati i Punës të rrisë numrin e inspektimeve për siguri dhe shëndet në punë
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës të marrë masa urgjente që të përmirësojë performancën e gjykatave në trajtimin e rasteve të të drejtave të punëtorëve
- Gjatë gjykimit të rasteve, gjyqtarët të zbatojnë udhëzuesin e politikës ndëshkimore
- Prokuroria e Shtetit të angazhohet në hetimin e shpejtë të rasteve të aksidenteve në punë
- Gjykimi i rasteve penale të kryhet në afatet optimale të parapara me ligjet aktuale



Funded by
the European Union

'Ky raport është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të projektit "Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të punës të grupeve të cenuara në tregun e punës". Përmbajtja e këtij artikulli është përgjegjësi e ATRC dhe BIRN Kosova dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkimit Evropian'.